

URDHËR
Nr. 675, datë 26.10.2023

**PËR ZËVENDËSIMIN E PËRKOHSHËM PËR NËNSHKRIMIN E
DOKUMENTEVE NË EMËR TË SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM**

Në mbështetje të neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; pikës 3, të nenit 15 të ligjit nr. 90/2012, datë 27.9.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Znj. Entela Çipa, drejtor i përgjithshëm i Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit Kulturor, që në mungesë dhe me porosi, të zëvendësojë për nënshkrimin e korrespondencave të përditshme shkresore, që janë kompetencë e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës.

2. Gjatë periudhës së zëvendësimit, të shqyrtojë dhe të miratojë çdo akt që kalon nëpërmjet sistemit *e-Aktet*, në emër dhe për llogari të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës.

3. Gjatë periudhës së zëvendësimit të miratojë dhe të nënshkruajë elektronikisht në emër dhe për llogari të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës në sistemin SIFQ dhe AFMIS.

4. Periudha e zëvendësimit është e vlefshme për periudhën 30.10.2023–6.11.2023.

5. Ngarkohet drejtori i përgjithshëm i Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit Kulturor, znj. Entela Çipa, për zbatimin e këtij urdhri, si dhe Sektori i Burimeve Njerëzore dhe i Arkiv-Protokollit për komunikimin e tij.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I
MINISTRISË SË KULTURËS
Zerina Bruci